

## 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2014

**Tabelë 1:** Veprimet e përkohshme në tregun e hapur  
(në milionë lekë\*)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore
03.07.2014		20,000.00	2,000.00
10.07.2014		16,300.00	2,000.00
17.07.2014		20,700.00	2,000.00
18.07.2014	2,000.00		
21.07.2014	2,000.00		
22.07.2014	2,000.00		
23.07.2014	1,000.00		
24.07.2014		27,500.00	2,000.00
31.07.2014		28,700.00	2,000.00
07.08.2014		26,460.00	2,000.00
14.08.2014		29,430.00	3,000.00
21.08.2014		31,500.00	2,000.00
22.08.2014	1,340.00		
28.08.2014		24,700.00	2,000.00
04.09.2014		27,500.00	2,000.00
11.09.2014		26,300.00	2,000.00
18.09.2014		28,160.00	2,000.00
25.09.2014		28,100.00	2,000.00

### 1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit dhe operacione të përhershme, me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së.

**Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 28.06 miliardë lekë, kundrejt 20.61 miliardë lekëve në tremujorin e dytë të vitit 2014. Likuiditeti mesatar i injektuar rezulton rreth 61% më i lartë se 1 vit më parë, kur kjo vlerë ishte rreth 17.38 mld lekë.**

Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 25.80 miliardë lekë në javë\*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëmujor, mesatarisht 2.07 miliardë lekë në javë\*. Injektimi njëditor, në datë 22.08.2014, synonte mbylljen e periudhës me teprica pozitive, duke shmangur njëkohësisht edhe nisjen e periudhës se re me teprica të larta.

Edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit është vijuar me operacionet për shitblerje me të drejta të plota, duke synuar uljen e zotërimit të BSH-së në bono thesari jo me shumë se niveli 70% i totalit të çdo emetimi. Duke qenë se portofoli i BSH-së, gjatë operacioneve në gjysmën e parë të vitit 2014, rezultonte të ishte 50 milion lekë më i lartë se niveli i fillimvitit, gjatë tremujorit të tretë u zhvillua një ankand për blerje bonosh thesari 12-mujore të sapoemtuara, me shumë të shpallur 400 milionë lekë, shoqëruar me ulje të riinvestimit në bono thesari 6-mujore për 450 milionë lekë. Ndërhyrja në blerje u realizua vetëm për 270 milionë lekë. Në vijim janë kryer tre ndërhyrje në treg të hapur për blerje të bonove të thesarit 12-mujore të sapoemtuara, realizuar për 465 milion lekë, pjesërisht korrigjuar nëpërmjet një ndërhyrjeje në shitje për 250 milion lekë. Portofoli i BSH-së, në fund të tremujorit të tretë, është 85 milion lekë më i lartë se në fillim të vitit 2014.

\* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.


## 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur në 27 raste, mesatarisht për 2.07 miliardë lekë, kundrejt 6 rasteve në tremujorin e kaluar, me mesatare përdorimi 0.11 miliardë lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 1 rast, në datë 22 gusht, për shumën 225 milionë lekë, kundrejt 6 rastesh përdorimi në tremujorin e kaluar, për mesatarisht 450 milionë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2014.

Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2011-2014 (me çmim blerjeje)




## 2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2014

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka vijuar të mos ndërhyjë në tregun valutor.

Grafik 2 Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e tretë të vitit 2014



## 2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të tretë, veprimi i vetëm midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave që blerja e përhershme e 23 milionë SDR-ve nga Ministria e Financave. Fondet e Ministrisë së Financave janë marrë në kuadër të programit EFF (*Extended Fund Facility*) me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 225.80 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	3,597.20	
TË TJERA (IDA, IBRD)	225.80	